



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër
12- Zyrtarisht /2026
Deçan, 05.06.2026

KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇAN / DEÇAN MUNICIPALITY	
NR. DOK. / NO. DOK. / NO. DOK.	12258
DI. / DI. / DI.	02
NR. / NR. / NR.	26.06.26
DEÇAN DEÇAN	

Për: Kryetarin e Komunës së Deçanit Z. Bashkim Ramosaj

Përmes: Drejtorit të Drejtorisë Znj. Laureta Zejnaj

Nga : UD Shefi i Drejtorisë Z. Muhamet Avdijaj

Lënda: Raport Pune për periudhën 04 Janar 2026 – 05 Qershor 2026, i
Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e
Deçanit.



Së bashku me këtë shkresë do gjeni edhe Raportin e punës për periudhë 04 .01. 2026 – 05.06.2026 për Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrit në Deçan.

R A P O R T P U N E

Për periudhën 04.01. 2026– 05.06.2026 i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Deçan

1. Shefi i Shërbimit njëkohësisht edhe zyrtari për RDPP së bashku me referentin e ndryshimeve kadastrale

Gjatë periudhës për të cilën po raportojmë përkatësisht prej fillimit të vitit 2025 e deri me datën e përpilimit të këtij raporti , Zyrtari për RDPP ka pranuar gjithsejtë **300** kërkesa nga palë të ndryshme për realizimin e të drejtave ligjore që dalin nga Regjistrimi i të Drejtave në Pronën e Paluajtshme (RDPP).

Nga të gjitha këto kërkesa deri me tani janë shqyrtuar **288** dhe për të njëjtat janë lëshuar aktvendime adekuate me të cilat palëve iu është njohtë e drejta ligjore e kërkuar ose ju ka refuzuar e njëjta kërkesë dhe ju ka dhënë e drejta e ankesës në organin e shkallës së dytë. Ndërsa **12** kërkesa janë në procedurë e sipër.

Aktvendimet me të cilat palës i është njohtë e drejta në RDPP, në afat ligjor dërgohen te referenti për ndryshime kadastrale i cili konform këtyre vendimeve bënë azhurimin në librat përkatës të elaboratit kadastral dhe të njëjta prapë i azhurnon duke i futur të dhënat në kompjuter përkatësisht në programin e SIKTK-së

Krahas këtyre punëve Zyrtari për RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit të shërbimit ka kryer edhe punë tjera nga lëmi i shërbimeve pronësoro juridike si dhe së bashku me Referentin për ndryshime kadastrale kanë kryer edhe punë tjera me urdhër të drejtorit .

2. Zyrtarët e mirëmbajtjes së Kadastrit

Në këtë sektor punojnë tre zyrtar për mirëmbajtjen e Kadastrit

Këta zyrtar gjatë periudhës raportuese i kanë pasur **210** azhurime të lëndëve nga tereni sipas kërkesë së palëve siç janë : Ndarja e parcelave, Bashkimi i parcelave, Regjistrimi i Objekteve, korrigjimi i sipërfaqeve, korrigjimi i mexhave dhe futja e të dhënave të reja në sistem. Këto lëndë të gjitha janë zgjedhur me përjashtim të **10** rasteve të cilat ende janë në procedurë e sipër.

Gjithashtu këta zyrtar gjatë kësaj periudhe kanë lëshuar **9** historiate dhe identifikime të mexhave sipas kërkesave të palëve dhe kanë lëshuar **269** kopje plani.


3. Referenti për pranimin e palëve

Gjatë periudhës për të cilën raportojmë, referenti për pranimin e palëve ka pranuar gjithsejtë **912** kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me dhënien e certifikatave të pronës së paluajtshme, kopjeve të planit dhe vërtetimeve me të cilat vërtetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri të paluajtshme, në territorin e Komunës.


I njëjti zyrtar i ka proceduar të gjitha këto kërkesa dhe për secilën kërkesë palët janë pajisur me dokumente përkatëse në afatin brenda ditës së paraqitjes së kërkesës. I njëjti punëtor krahas këtyre punëve ka kryer edhe punët e përpunuesit në SIKTK. Gjithsejt lëndë të kryera nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadaster deri në përpilimin e këtij raporti janë **1683** lëndë të ndryshme.

Kjo Drejtori krahas këtyre punëve të evidentuara më lartë ka kryer edhe punë tjera të parashtruara konform kërkesave të palëve private dhe organeve komunale.

Raportin e përpiloi :
UD Shefi i kësaj Drejtorie
Muhamet Avdijaj

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Muhamet Avdijaj', written over a horizontal line.

D r e j t o r i
Laureta Zejnaj

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Laureta Zejnaj', written over a horizontal line. To the right of the signature is a small handwritten mark resembling a circle with a dot.